



INTERNATSORDNUNG
LOYOLA-GYMNASIUM
Gymnasium mit Internat

Prizren, am 29.05.2015

Arianit Çollaku
Internatsleitung

Walter Happel SJ
Direktor ALG

RENDI KONVIKTIT
LOYOLA-GYMNASIUM
Gjimnaz me konvikt

I. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore vërtetohen:

- OBLIGIMET E KONVIKTIT
- OBLIGIMET E PRINDËRVE/MBIKQYRËSVE
- OBLIGIMET E NXËNSEVE/ËVE
- KRITERET PËR LARGIMIN NGA KONVIKTI
- MASAT PEDAGOGJIKE

II. OBLIGIMET E KONVIKTIT

Neni 2

Konvikti obligohet që nxënseve/ëve tu sigurojë:

1. Kushte optimale për mësim dhe edukim nën mbikqyrjen e edukatores/it, si dhe kujdes për përparim të suksesshëm në përvetsimin e kërkesave mësimore.
2. Ambiente të përshtatshme për banim dhe mësim.
3. Ushqim të përshtatshëm (mëngjes, drekë, darkë).
4. Kujdes dhe kontrolla shëndetsore në rast të sëmundjeve të lehta, si dhe udhëzime të mjeku.
5. Lajmërime prindërve/mbikqyrësve mbi suksesin dhe sjelljen e nxënseve/ëve

III. OBLIGIMET E PRINDËRVE - MBIKQYRËSVE

Neni 3

Prindërit/mbikqyrësit sipas përgjegjesive morale, materiale, edukative obligohen:

1. Prindi së bashku me edukatoren/in vazhdimisht të përcjellë suksesin dhe sjelljen e nxënës/sit gjatë shkollimit, jetës dhe punës në konvikt.
2. Pagimin në tri këste në fillim të muajve shtator, janar dhe maj.
3. Pagimi i dëmit të cilin nxënësja/si e bën nga pakujdesi, si dhe pjesën e dëmit për të cilin



nuk dihet shkaktari (grupi përgjegjes).

IV. OBLIGIMET E NXËNËSEVE /ËVE

Neni 4

1. Me përgjegjesi të kryhet detyra kryesore - mësimi.
2. Çdo herë të lajmërohen edukatores/it
3. Me ndërgjegje dhe përgjegjësi të kryhet kujdestaria e paraparë sipas planprogramit të caktuar dhe detyrat e tjera në konvikt
4. Ta mbrojë imazhin e vetë, të konviktit si dhe të rrethit dhe bashkësisë ku jeton.
5. T'i ruajë gjërat e veta të vleshme si dhe të hollat
6. Mes veti dhe me personelin e konviktit/shkollës të edukojnë sjellje të mira, besim të anasjelltë si dhe relacione të shëndosha ndërnjerëzore.
7. Të ruhet dhe në mënyrë racionale të përdoret pasuria e konviktit që u është besuar për shfrytëzim.
8. Të kenë kujdes në higjienën personale, të konviktit, si dhe pamjen estetike të shtëpisë dhe ambientit.
9. Çdo dëm i shkaktuar paguhet materialisht.
10. Dorëheqja apo largimi nga konvikti lajmërohet 15 ditë përpara.
11. Janë të obliguar që ta lusin prindin që të na lajmërojë në konvikt kur nxënësja/si arrinë në shtëpi për vikend apo pushime.
12. Janë të obliguar që suksesin e tyre t'u tregojnë edukatores/it
13. Me pedanteri t'i rregullojnë gjërat e veta dhe dhomën kur të shkojnë në shtëpi.

Neni 5

Duhet të mbahet rendi i ditës sipas orarit dhe kushteve të nxënësve/ëve:

1. Mëngjesin do të jetë prej 7:00 - 7:45, të dielave deri 9:00.
2. Dreka prej 13:00 - 15:00.
3. Koha e lirë 15:00 - 16:00.
4. Mësimi pasdite prej 16:00 -18:00 ditëve të punës, sipas nevojës edhe prej 20:00 -21:00.
5. Darka 18:00.
6. Gjumi prej 21:00.

Neni 6



Që mos të vijë deri tek veset e padëshirueshme nxënëseve/ëve nuk i u lejohe:

1. Kryerja e punëve personale gjatë kohës së caktuar për mësim përveç në rast nevojë- të kërkuar nga edukatorët/ët përgjegjës
2. Prishja e qetësisë gjatë mësimit apo fjetjes.
3. Largimi nga konvikti pa lejen e edukatorës/it.
4. Shprehjet paedukatë sikurse janë: sharjet, fjalët ofenduese etj.
5. Përdorimi i pijeve alkoolike dhe gjërave tjera narkotike.
6. Pirja e duhanit.
7. Marrja e enëve nga kuzhina apo trapezaria (dhoma e bukës).
8. Mbathja e këpucëve të cilat prishin qetësinë në konvikt.
9. Zvazritja në dritare apo rreth të oborrit.
10. Futja e mysafirëve në dhomë të fjetjes pa lejen dhe dijen e edukatores/it.
11. Fjetja jashtë konviktit pa miratimin e prindërve.
12. Dalja jashtë dhome në pixhama.
13. Përdorimi i veshmbathjeve të huja pa lejen e pronares/it.
14. Futja e nxënëseve/ëve nëpër dhoma të huaja dhe marrja e gjërave pa leje.
15. Zhurma në koridore dhe thirrja me zë të lartë.
16. Përplasja e dyerve.
17. Terja e rrobave në dhoma (nxemje qëndrore).
18. Vëndosja e gjërave të lagta mbi mobile.
19. Biseda në telefonë gjatë orarit të mësimit (lihen porositë në recepcion).

Përndryshe duhet të kenë kujdes në kohëzgjatjen e bisedave telefonike.

Neni 7

Me rastin e largimit nxënësja/si detyrohet:

1. T'i kthej gjërat edukatores/it përgjegjes.
2. T'i paguaj të gjitha shpenzimet me kohë si dhe dëmshpërblimet.

Në rast që nxënësja/si largohet pa bërë pagesen, këto shpenzime i paguajnë prindrit apo mbikëqyrsit e tyre.



V. KRITERET PËR PRANIMIN E NXËNËSVE NË KONVIKT

Neni 8

Si kriter për regjistrim përveç lutjes për pranim duhet të paraqesin edhe dokumentet tjera përkatëse.

Neni 9

Nxënëset/sit të cilët kanë qenë të rregulltë në vitin e kaluar, menjëherë janë të regjistruar në vitin e ardhshëm, me përjashtim të këtyre rasteve:

1. Nëse pagesa nuk është berë rregullisht.
2. Nëse nuk janë paguar dëmshpërblimet të bëra me fajin e vetë apo dëmet e bëra në grup.
3. Nëse nuk i u përmbahen rregulloreve të konviktit.
4. Nëse ka përdorur alkool, drogë apo mjete tjera narkotike.
5. Nëse në vitin paraprak i u është tërhequr vërejtje e rënd pedagogjike
6. Dhe rastet e tjera që vendosen nga ana e timit edukativ në përputhshmëri me rregullat e konviktit.

VI. KRITERET PËR LARGIMIN NGA KONVIKTI

Neni 10

Deri te largimi nga konvikti, gjegjësisht prishja e marrëveshjes vije në këto raste:

1. Në kërkesën e prindërve apo mbikqyrësve të nxënësve/ëve.
2. Nëse nxënësja/si me vetëdashje e lëshon konviktin.
3. Nëse nxënësja/si nuk bën pagimin e dëmshpërplimit.
4. Nëse nxënësja/si nuk kryen mirë detyrimet e paraqitura në Nenin 4 të rregullores.
5. Nëse nxënësja/si përjashtohet apo e lëshon me dëshirë shkollën.
6. Nëse nxënësja/si vjedhë gjërat e konviktit apo shokut/shoqes së saj.
7. Nëse nxënësja/si për hir të mosrespektimit e urdhresave të rregulloreve të konviktit u tërhiqet vërejtja.



8. Largimet mund të bëhen edhe në rastet tjera në përputhshmëri me rregulloret e konviktit, për këtë vendos drejtuesja duke u përgjegjur udhëzimeve të edukatoreve/ëve.

VII. MASAT PEDAGOGJIKE

Neni 11

1. Masat shpërblyese janë:
 - Lëvdatat dhe shpërblimet. Këto u ndahen nxënësve/ëve, grupeve për suksese në mësim dhe sjellje të mira, si dhe të dalluarit në aktivitete tjera të ndryshme.
2. Masat tjera pedagogjike janë:
 - Qortimet e edukatorës/it.
 - Vërejtjet nga ana e këshillit edukues.
 - Vërejtje para largimit nga ana e këshillit edukues.
 - Largimi nga konvikti u bëhet atyre nxënësve/ëve të cilët nuk përmbushin detyrat dhe obligimet e tyre në të respektuarit të urdhresave të ligjit, rregulloreve të konviktit si dhe urdhresat e kësaj rregulloreje.

VIII. URDHRESAT PËRFUNDIMTARE

Neni 12

Ndryshimet dhe plotsimet e kësaj rregulloreje bëhen në të njëjten mënyrë si janë edhe krijuar.

Neni 13

Kjo rregullore aplikohet në ditën e tetë të shpalljes në tabelën e shpalljeve të konviktit.

Prizren, 29.05.2015

Arianit Çollaku
Udhëheqës i konviktit

Walter Happel SJ
Drejtore ALG

